



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË

Adresa sheshi "RILINDJA"

TEL 08122225 ;22 32 FAX 08122225

e-mail: [bashkia.kolonje@gmail.com](mailto:bashkia.kolonje@gmail.com)

Nr. 1747 Prot

Kolonjë më datë. 11/07 / 2016

KONTRATË PROKURIMI

PUNË

NR. 6 .DATË. 11/07 / 2016

OBJEKTI

Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit "RILINDJA" Ersekë

Lidhur ndërmjet palëve

BASHKIA KOLONJË " Autoriteti Kontraktor "

Dhe

" Kontraktuesi "

**Bashkimit të Operatorëve ekonomik**

***ARKONSTUDIO Sh.p.k dhe ERAL CONSTRUCTION COMPANY Shpk***

BASHKIA KOLONJË

ARKONSTUDIO Sh.p.k

Eral Construction Company Shpk

## KONTRATË SIPËRMARRJE

Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit "RILINDJA" Ersekë

Lidhur sot më datë. 11.05 2016 në bazë të nenit 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, midis:

Bashkisë Kolonjë e përfaqësuar nga Z.Arben MALO, Kryetar, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me adresë: Sheshi "RILINDJA" që më poshtë do të quhet "Autoriteti Kontraktor"

dhe

Bashkimit të Operatorëve ekonomik " **ARKONSTUDIO Sh.p.k** " dhe " **Eral Construction Company Shpk** ", regjistruar respektivisht si më poshtë shënuar:

Shoqëria " **ARKONSTUDIO Sh.p.k** " me regjistër fillestar CN – 605598-08-14, datë 18.08.2014 me liçensë profesionale të shoqërisë NZ. 7087 / 2, me vlefshmëri pa afat kohor lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktues, me seli të shoqërisë: **Tiranë**, Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga Frosina Plaku, Pallati Nr.21, Shkalla A, Apartamenti Nr.5, Kati III - të me NUIS: L 42019004 I, me përfaqësues ligjor të shoqërisë Z.Krenar DILA

Shoqëria " **Eral Construction Company Shpk** " me regjistër fillestar CN – 184866-10-08, datë 30.10.2008, me liçensë profesionale të shoqërisë NZ. 6083 / 7, me vlefshmëri pa afat kohor, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktues, me seli të shoqërisë: Gjirokastrë, rruga Ura e Lumit, Zona Kadastrale Nr.1053 dhe numër pasurie 186/3 me NUIS: K 82230002 K, me përfaqësues ligjor të shoqërisë Z.Ervin QËNDRO.

Bashkimi i operatorëve ekonomik " **ARKONSTUDIO Sh.p.k** " dhe " **Eral Construction Company Shpk** ", me anë të marrveshjes për bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive, lidhur më datë 30.05.2016, në Tiranë me Nr.1198 Rep dhe Nr.988 Kol, kanë rënë dakort të bëjnë bashkimin e përkohshëm të shoqërive për realizimin e objektit: **Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit "RILINDJA" Ersekë** ku shoqëria " **ARKONSTUDIO Sh.p.k** " do të kryejë 52.8 % të volumit të punimeve, ndërsa shoqëria " **Eral Construction Company Shpk** " do të kryejë 47.2 % të volumit të punimeve .

Me anë të Prokurës së Posaçme të datës 30.05.2016, me Nr.1199 Rep dhe Nr.989 Kol, në Tiranë shoqëritë: " **ARKONSTUDIO Sh.p.k** " dhe " **Eral Construction Company Shpk** " autorizojnë shoqërinë " **ARKONSTUDIO Sh.p.k** " me Përfaqësues Ligjor Z.Krenar DILA të jetë përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të shoqërive në realizimin e objektit të Kontratës.

BASHKIA KOLONJË



ARKONSTUDIO Sh.p.k



Eral Construction Company Shpk



*Neni 1. Objekti i Kontratës*

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është sipërmarja me objekt : Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit “ RILINDJA ” Ersekë në përputhje të plotë me projekt - zbatimin e objektit.

*Neni 2. Vlera e Kontratës*

- 2.1 Kontrata lidhet me një vlerë totale: 51 132 805 ( Pesëdhjetënjëmilionenjëqinde tridhjetëedymijëeteëqindepesë) lekë me TVSH.
- 2.2 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga kontraktori në ofertën e tij.

*Neni 3. Afati i realizimit të punimeve*

- 3.1 Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 7 ( shtatë) muaj kalendarik nga data e lidhjes se kontrates.

*Neni 4. Gjuha e Kontratës*

- 4.1 Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

*Neni 5. Përkufizime*

- 5.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 5.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 5.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve, e vërtetuar nga enti prokurues.
- 5.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



- 5.5 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 5.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 5.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 5.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 5.9 “Data e fillimit” është përfshirë në të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 5.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 5.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 5.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 5.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 5.14 “Drejtues projekti” do të thotë Mbikqyrësi i Punimeve i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 5.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 5.16 “Drejtor Teknik” është personi i caktuar nga Kontraktori në ofertën e tij, i cili përmbush kualifikimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontaktues si dhe i aprovuar prej tij, i cili është personi përgjegjës nga ana e Kontraktorit për zbatimin e punimeve në Kantier deri në përfundimin e tyre, i pranishëm në kantierin e ndertimit dhe është përfaqësuesi i Kontraktuesit në të gjitha kontaktet me përfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor.
- 5.17 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 5.18 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



- 5.19 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 5.20 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 5.21 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 5.22 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 5.23 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.
- 5.24 "formulari i deklaramentit të ofertës" - është dokumenti i plotësuar që kontraktori ka dorëzuar në datën e hapjes së tenderit dhe është pranuar nga Enti Prokurues.
- 5.25 "Data e përfundimit të kontratës" është data e vërtetuar nga Enti Prokurues.
- 5.26 "Ditët" janë ditë kalendarike dhe "muajt" janë muaj kalendarik.
- 5.27 "Ndryshimi" është një udhëzim që jep Autoriteti Kontraktori papaparashikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.
- 5.28 "Raste të kompensuara" janë ato që përcaktohen në pikën 34.
- 5.29 "Periudha e garancisë" së difekteve është 24 (njëzetekatër) muaj.
- 5.30 "Skica (vizatimet)" përfshijnë projektet dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga Enti Prokurues për përmbushjen e Kontratës.
- 5.31 "Specifikimet" janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit në dokumentat standarte të tenderit dhe çdo modifikim ose shtesë e bërë dhe e miratuar me shkrim nga Investitori.
- 5.32 "Punimet" janë punimet që duhet të kryhen nga Kontraktori në përputhje me kontratën, projektin dhe ndryshimet e tij.

#### *Neni 6. Dokumentat e tenderit*

- 6.1 Të gjitha dokumentat e tenderit të dhëna nga Autoriteti Kontraktor dhe të marra në formën e ofertës nga kontraktori janë pjesë përbërëse dhe integrale e kësaj kontrate.

**BASHKIA/KOLONJË**

**ARKONSTUDIO Sh.p.k**

**Eral Construction Company Shpk**



## *Neni 7. Prona Intelektuale*

- 7.1 Të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do ti përkasin Autoritetit Kontraktor i cili i përdor ato sipas gjykimit të tij.
- 7.2 Kontraktori pas përfundimit të kontratës duhet ti dorëzojë Autoritetit kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, skicimet, specifikimet planet llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose të pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës, Kontraktori mund te mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave po nuk mund ti përdorë për qëllime që kanë lidhje me kontratën pa lejen me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 7.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor për zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 7.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## *Neni 8. Mbikqyrësi i Punimeve*

- 8.1 Mbikqyrësi i punimeve për realizimin e kontratës me objekt; Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit " RILINDJA " Ersekë , do të jetë bashkimi i operatorëve ekonomik Transport Highway Consulting Shpk dhe Erald-G Shpk, referuar kontratës së lidhur midis Operatorit ekonomik sipërcituar dhe Bashkisë Kolonjë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.
- 8.2 Bashkimi i operatorëve ekonomik "Transport Highway Consulting " shpk dhe " ERALD-G " shpk, me anë të marrëveshjes për bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive, lidhur më datë 04.07.2016, në Tiranë me Nr.2566 Rep dhe Nr.885 Kol, kanë rënë dakord të bëjnë bashkimin e përkohshëm të shoqërive për realizimin e objektit: Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit " RILINDJA " Ersekë ku operatori ekonomik "Transport Highway Consulting " shpk do të realizojë 80 % të fitimit dhe pjesëmarrjes ndërsa, operatori ekonomik " ERALD-G " shpk do të realizojë 20 % të fitimit dhe pjesëmarrjes. Me anë të Prokurës së Posaçme të datës 04.07.2016, në Tiranë me Nr.2567 Rep dhe Nr.886 Kol operatorët ekonomik Transport Highway Consulting Shpk dhe Erald-G Shpk autorizojnë shoqërinë " Transport Highway Consulting " Sh.p.k

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



me Përfaqësues Ligjor Z. Engjell Caka të jetë përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të shoqërive në realizimin e objektit të Kontratës.

- 8.3 Detyrat e mbikqyrësit të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhe jane te detajuara ne kontraten e sherbimit te lidhur me këta të fundit.
- 8.4 Në rast se mbikqyrësi do të ndryshohet Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktorin.
- 8.5 Mbikqyrësi i Punimeve do të vendosë për çështjet e kontratës midis Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 8.6 Mbikqyrësi i Punimeve mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij te të tjerët përveç zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve. Mbikqyrësi i Punimeve duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për delegimet e bëra apo të deleguara.
- 8.7 Mbikqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë Punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
- 8.8 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga mbikqyrësi i punimeve.

#### *Neni 9. Personeli i Kontraktorit*

- 9.1 Kontraktori është i detyruar të punësojë në kantier për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyrësi i Punimeve vetëm personelin inxhinjerik të deklaruar në ofertë.
- 9.2 Mbikqyrësi i Punimeve do ti propozojë Autoritetit kontraktor për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Kontraktorit.
- 9.3 Në qoftë se Mbikqyrësi i Punimeve i kërkon Kontraktorit që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtore të Kontraktorit, duke theksuar arsyet, Kontraktori do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.
- 9.4 Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtorin Teknik. Drejtori Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesi Teknik i Punimeve të objektit i cili do te jete Z.Krenar DILA,i përfshirë në licensën profesionale të shoqërisë NZ.7087/2 lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



- 9.5 Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:
- Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit
  - Te jete i pranishem gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve ne kantier;
  - Te jetë i pranishëm dhe të përfaqësojë Kontraktorin në të gjitha kontaktet, takimet zyrtare apo mbledhjet që Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontraktorin dhe Drejtorin e Projektit në zgjidhjen e diskutimin e çështjeve teknike e profesionale që lindin gjate zbatimit te punimeve;
  - Është përgjegjës per dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt;
  - Mban Korrespondencën zyrtare me Mbikqyrësin e Punimeve;
  - Është përgjegjës për ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
  - Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

9.6 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë Mbikqyrësin e Punimeve i cili vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

9.7 Drejtuesi teknik ne këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlereson se ai nuk permbush kualifikimet e percaktuara ne Dokumentat e tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Mbikqyrësin e Punimeve i cili vë në dijeni Autoritetin Kontraktor.

#### *Neni 10. Detyrimet e Kontraktorit*

10.1 Kontraktori do të kryejë punimet në përputhje me projektet e ndryshimet e miratuara e të dhëna nga Autoriteti Kontraktor dhe në përputhje me K.T. të zbatimit të RSH, specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

10.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rasteve kur gabimi është aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta reklamonte tek Autoriteti Kontraktor.

10.3 Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

10.4 Drejtuesi Teknik i Punimeve në kantier, është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku të përfshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdhërat e dhëna për

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**





projektin. Ky ditar në çdo kohë do ti vihet në dispozicion Mbikqyrësit të punimeve, grupit të kolaudimit dhe Investitorit.

- 10.5 Kontraktori do të kryejë punime me nënsipërmarrje vetëm nëse Autoriteti Kontaktor e ka lejuar këtë në dokumentat e tenderit vetëm pasi të ketë marrë miratimin e Investitorit.
- 10.6 Nënkontraktori do të jetë subjekti i deklaruar si nënkontraktor në ofertën e Kontraktorit dhe do të kryejë vetëm punimet e deklaruara në ofertë dhe jo më shumë se 40% të vlerës së Kontratës.
- 10.7 Marrëdhëniet e n/sipërmarrjes do rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje e cila përcakton qartë nënsipërmarrjen dhe që në çdo rast është e detyruar të respektojë të gjitha detyrimet e kontrates së sipërmarrjes. Përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktor mbetet gjithmone Kontraktori kryesor i punimeve.
- 10.8 Kontraktori mund ti japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktori të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës sic thuhet në nenin Informacioni Konfidencial.
- 10.9 Kontraktori ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Investitorit.
- 10.10 Kontraktori është i detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së ambientit duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.
- 10.11 Kontraktori është i detyruar të rrethojë kantierin e punimeve të ndërtimit në datën e fillimit dhe hyrjes në kantier sipas standarteve të përcaktuara.
- 10.12 Kontraktori është i detyruar të lagë me ujë zonën e kantierit të punimeve të ndërtimit me qëllim eliminimin e ndotjes së mjedisit si rrjedhim i kryerjes së punimeve.
- 10.13 Kontraktori është i detyruar të pajisë me uniformë pune të gjithë personelin punëtor. Uniformat e punës duhet të kenë të evidentuar emrin e kontraktorit si dhe të jenë të pajisura me shirita fosforike për tu dalluar natën.
- 10.14 Kontraktori është i detyruar të përdori mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit. Këto mjete duhet të vendosen në mënyrë të dukshme për të gjithë.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



10.15 Kontraktori është i detyruar të vendosë në kantier të gjitha makineritë dhe mjetet e paraqitura në ofertë, mbi bazën e të cilës ai është shpallur fitues. Mjetet e qarkullimit duhet të jenë të pajisura me lejet përkatëse.

10.16 Në rast të mos respektimit të dispozitave të parashikuara në pikën 10.8 Mbikqyrësi i punimeve i bën njoftim me shkrim Kontraktorit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart dhe korrigjimin e tyre. Në rast se Kontraktori nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëhere Mbikqyrësi i punimeve i propozon Investitorit, Autoritetit Kontraktor aplikimin e një penaliteti në masën nga 50.000 lekë deri 200.000 lekë, penaliteti i cili do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.

10.17 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor sic kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve

10.18 Te gjitha te drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do të perkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund ti perdore ato sipas gjykimit te tij.

10.19 Kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

#### *Neni 11: Kontrolli i Cilësisë*

11.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

11.2 Sapo kontrata të fillojë efektet e saj teknike dhe financiare, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

11.3 Mbikqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

11.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



### *Neni 12. Disponimi i Kantierit*

12.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

### *Neni 13. Ngritja e Kantierit*

13.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për skicimin e Ngritjes së Kantierit.

13.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyrësi i Punimeve për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

### *Neni 14. Zbulimet*

14.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

### *Neni 15. Pasuria*

15.1 Të gjitha punimet e kryera dhe materialet e montuara për realizimin e objektit do të konsiderohen si pronë e Investitorit në rast prishje kontrate.

### *Neni 16. Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit*

16.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

16.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

### *Neni 17. Ekzekutimi i Punimeve*

17.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjehere me nenshkrimin e saj, kohë në të cilën do të fillojnë dhe efektet teknike -finaciare të zbatimit të kësaj kontrate dhe duhet ti mbarojë Punët brenda afatit të përcaktuar në Nenin 3 të kësaj kontrate.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



### *Neni 18. Sigurimi teknik dhe mjedisor*

- 18.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 18.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rrezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

### *Neni 19 Testimet dhe Inspektimet*

- 19.1 Kontraktori është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyrësi i Punimeve dhe nga normativat në fuqi.
- 19.2 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kostoja e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda kushteve të çmimit të kontratës.
- 19.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktorit të bëjë teste ose inspekte shtesë të pa parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se ndërtimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës.
- 19.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim ndertimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 19.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve të ndërtimit nuk do ta lirojë Kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

### *Neni 20 Garancitë*

- 20.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materialet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
- 20.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.
- 20.3 Materialet e përdorura duhet të përmbushin standartet shtetërore në fuqi.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



*Neni 21 Sigurimi Teknik*

21.1 Kontraktori është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë në kantierin e ndërtimit, duke zbatuar masat korrigjuese dhe rregullat e sigurimit teknik për gjithë personelin sikurse përcoktohet në legjislacionin Shqiptar.

*Neni 22 Rreziqet e Kontraktorit dhe Forca Madhore*

22.1 Kontraktori ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve e deri në fund të periudhës së garancisë për difektet që mund të shfaqen në objekt sipas të dhënave të kontratës. Kontraktori deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimeve të personelit, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe paisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit).

22.2 Kontraktori nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës jo për fajin e tij, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim në se dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

22.3 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Investitorit qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrengime të karantinës dhe embargo tranziti.

22.4 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Investitorin. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin e kontratës deri në masën e mos pengesës nga Forca Madhore.

*Neni 23: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit*

23.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

23.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

23.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.pfk**



**Eral Construction Company Shpk**



- 23.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.
- 23.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.


#### *Neni 24. Sigurimi*

- 24.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin me vlerë totale 5 113 280.5 ( Pesëmilione njëqindetrembëdhjetëmijëedeqindetëdhjetë pikë pesë ) Lekë me tvsh me emra të përbashkët të investitorit dhe Kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në datën e realizimit të plote të ndërtimeve, për humbje ose dëmtim të Ndërtimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 24.2 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do të dorëzohen Mbikqyrësit të Punimeve për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse Kontraktori dështon të sigurojë çertifikatat e kërkuara të siguracionit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të çertifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktorit.
- 24.3 Ndryshime në kushtet dhe afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Investitorit.


#### *Neni 25. Preventivi*

- 25.1 Kontrata përfshin një preventiv për njësi. Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë.
- 25.2 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit me çmimin në njësi për secilin zë punimesh.
- 25.3 Për zërat e reja, të parashikuara në preventiv përveç dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune e cila i paraqitet Mbikqyrësit të

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



Punimeve nga Kontraktori. Mbikqyrësi i Punimeve pasi bën kontrollin e analizës teknike ia con për miratim Autoritetit Kontraktor.

25.4 Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.

#### *Neni 26        Negociatat dhe Amendamentet*

26.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që kanë përbërë bazën e përzgjedhjes së Kontraktorit.

26.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë dhe duke u referuar shprehimisht kontratës. Çdo shtesë ose ndryshim Amendamenti do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se nënshkruhet nga të dyja palët ose nga persona të autorizuar prej tyre.

26.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, në të cilën të specifikohet data dhe të nënshkruhen nga pala ose nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

#### *Neni 27        Ndryshimi i Porosisë*

27.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe e nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

27.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

27.3 Autoriteti Kontraktor mund që në çdo kohë të porosisë Kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës sa më poshtë vijon:

- Korrigjime në skicimin, vizatimin ose specifikimet e Ndertimeve;
- Korrigjime në materiale;
- Korrigjime në sasi.

27.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në skedimin e dorëzimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të trupëzojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k    Eral Construction Company Shpk**



- 27.5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem ne se nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 28.2 te kesaj kontrate.
- 27.6 Çdo ndryshim i urdhëruar nga Investitori, do të jetë objekt i një proces - verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Investitori. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Investitorit dhe në baze të llogarive përkatëse të bëra nga Kontraktori dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune shprehur në preventiv.
- 27.7 Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohen zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.
- 27.8 Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndyshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit dhe fondit rezervë të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor ngarkon Mbikqyrësin e punimeve për të sistemuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato .

#### **Neni 28 Programi**

- 28.1 Brenda 5 ditëve nga fillimi i efekteve teknike dhe financiare të kontratës kontraktori do ti paraqes për miratim Mbikqyrësit të Punimeve një program, në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së punimeve dhe grafiku kohor. Kontraktori do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar. Kontraktori ka të drejtë t'i propozojë Mbikqyrësit të punimeve ndryshime në grafikun e punimeve duke i motivuar ato. Në këtë rast Mbikqyrësi i Punimeve miraton ndryshime në program vetëm nëse ky ndryshim nuk do të ndikonte në afatin e realizimit të punimeve. Mbikqyrësi i punimeve mund të kërkojë rishikimin e grafikut të punimeve për të përshpejtuar realizimin e tyre gjatë realizimit të punimeve.
- 28.2 Në rast se mund ose lind nevoja e dorëzimit të pjesshëm të punimeve këto parashikohen në grafikun e punimeve ose në ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga investitori.
- 28.3 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**





*Neni 29 Korrigjimi i Difekteve*

- 29.1 Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Autoriteti Kontraktor konstatohet një difekt Kontraktori është i detyruar ta korrigjojë atë brenda afatit që i lihet me shkrim por jo më vonë se 15 ditë.
- 29.2 Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Autoriteti Kontraktor do të njoftojë Kontraktorin lidhur me çdo difekt para mbarimit të kësaj periudhe. Për eliminimin e difekteve lihet një afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret por jo më shumë se 15 ditë.
- 29.3 Periudha e garancisë për difektet është afati 24 muaj. Me përfundimin e kësaj periudhe Kontraktori paraqit kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila i është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit, brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korrigjimi i difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Në se janë kryer gjithë korrigjimet e difekteve atëhere hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.
- 29.4 Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

*Neni 30. Difektet e Pakorrigjuara*

- 30.1 Në qoftë se Kontraktori nuk korrigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar, Autoriteti Kontraktor do të vlerësojë koston e korrigjimit të difektit, dhe Kontraktori do të paguaj këtë shumë, së bashku me një gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Autoriteti Kontraktor do ta mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione.
- 30.2 Në se me përfundimin e periudhës së garancisë Kontraktori nuk ka korrigjuar difektet e konstatuara Autoriteti Kontraktori zbret nga garancia deri ne konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.

*Neni 31 Situacionet*

- 31.1 Kontraktori do t'i paraqesë Mbikqyrësit të Punimeve brenda 5 ditëve të para të çdo muaji situacionet mujore progresive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të mëparëshme, garancinë e difekteve, paradhënien etj., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



31.2 Mbikqyrësi i Punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga Kontraktori dhe do të vërtetojë shumën që duhet ti paguhet Kontraktorit brenda 10 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve të kryera.

31.3 Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventiv, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompensuara pa prekur fondin rezervë i cili do financohet në situacionin përfundimtar në se ka dokumenta që argumentojnë përdorimin e tij.

### *Neni 32 Kushtet e pagesës*

32.1 Pagesat për çdo situacion punimesh do të kryhen nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit nga Mbikqyrësi i Punimeve tek Autoriteti Kontraktor. Pagesat e situacioneve do të kryhen në llogarine bankare 422811977 pranë Bankës Kombëtare Tregëtare me kod IBAN AL8620511227811977CLCPCLALLA

32.2 Financimi i objektit me fonde të vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve viti 2016, Grandi "Infrastruktura vendore dhe rajonale".

32.3 Pagesa e situacioneve do të kryhet sipas financimit të parashikuar në pikën 2 të kësaj kontrate.

32.4 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

### *Neni 33. Rastet e Kompensuara*

33.1 Rastet e kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohen si vijojnë:

- a) Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specififikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.
- b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon Kontraktorin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve.
- c) Autoritet Publike ose Autoriteti Kontraktor shkaktojnë vonesa në lirimin e sheshit të ndërtimit për Kontraktorin.
- d) Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye lëshimin e çertifikatës së marrjes në dorëzim.

BASHKIA KOLONJË



ARKONSTUDIO Sh.p.k



Eral Construction Company Shpk



- 33.2 Kompensimi i rasteve të sipërpërmendura do të bëhet si vijon:  
Për vonesat e përmendura në pikat 33.1 (a,b,c,d) Autoriteti Kontraktor do të njohë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi atë të parashikuar në këtë kontratë.

**Neni 34 Taksat**

- 34.1 Kontraktori është i detyruar të paguajë të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar. Për taksat e përcaktuara në legjislacionin që ka hyrë në fuqi 28 ditë para datës së hapjes së tenderit, të cilat Kontraktori duhet ti ketë marrë parasysh në vlerën e kontratës, Autoriteti Kontraktor nuk do ti njohë asnjë shtesë pagese.
- 34.2 Nëse Kontraktori nuk është i rregjistruar si subjekt që ushtron aktivitet në Bashkinë Kolonjë është i detyruar të shlyejë ato taksa dhe tarifa vendore që kanë të bëjnë me realizimin e aktivitetit të përkohshëm në Bashkinë Kolonjë .

**Neni 35 Dëmshpërblimi për Vonesat**

- 35.1 Kontraktori do të paguajë Investitorit dëmshpërblimin për vonesa në afatin e përfundimit të punimeve në masën 2/1000 në ditë të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
- 35.2 Sasia e përgjithshme e dëmeve të likujduara nuk do të tejkalojë 25% të vlerës së Kontratës. Autoriteti Kontraktor do të zbrisë dëmshpërblimin për vonesat nga pagesa e fundit e Kontraktor.

**Neni 36 Garancia e Difekteve**

- 36.1 Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës që do të mbahet nga çdo situacion Kontraktorit si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe sanksionet e parashikuara në këtë kontratë.


**Neni 37 Kostoja e Riparimeve**

- 37.1 Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij nëqoftëse humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.
- 37.2 Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësisë së kontratës ose të punës jo cilësore të Kontraktor do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

**BASHKIA KOLONJË**

**ARKONSTUDIO Sh.p.k**

**Eral Construction Company Shpk**



*Neni 38*

*Marrja në Dorëzim e Punimeve*

- 38.1 Kontraktori pas përfundimit të Punimeve njofton me shkrim Mbikqyrësin e Punimeve dhe Investitorin. Në se Mbikqyrësi nuk ka vërejtje ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve. Kontraktori pas njoftimit të përfundimit të punimeve i paraqet brenda 30 ditëve Mbikqyrësit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera. Mbikqyrësi i Punimeve mbas verifikimeve brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij i'a paraqet gjithë dokumentacionin Investitorit.
- 38.2 Kontraktori duhet t'i kërkojë Mbikqyrësit të punimeve t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe mbikqyrësi i punimeve do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.
- 38.3 Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, mbikqyrësi i punimeve do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.
- 38.4 Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon defekte në Punime, mbikqyrësi i punimeve duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.
- 38.5 Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraqet komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave të kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të Kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancisë së punimeve.
- 38.6 Në fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyrësi i Punimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të objektit do të përpilojnë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes në dorëzim të veprës, objekt i kësaj kontrate.

*Neni 39*

*Zgjidhja e Kontratës*

- 39.1 Autoriteti Kontraktor ose Kontraktori mund të pezullojë kontratën kur vëren shkelje themelore të saj.
- 39.2 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:
- a) Kontraktori nuk fillon punë brenda 5 ditëve nga fillimi i zbatimit të kontratës si dhe në rastet kur ndalohen punimet me shumë së 10 ditë kur nuk parashikohet në programin e punës dhe ndalimi i punimeve nuk është i autorizuar nga Mbikqyrësi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



- b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon pezullimin e punimeve duke njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktorin.
- c) Kontraktori falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit të shoqërisë.
- d) Kontraktori vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korrigjimet e difekteve të propozuara nga Mbikqyrësi i Punimeve.
- e) Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën për shkak të Interesit Publik, në cdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarre për ti shërbyer më mirë interesit publik.

**Neni 40** *Pagesa pas Zgjidhjes së Kontratës*

40.1 Në rast se kontrata priset nga Autoriteti Kontraktor për arsye objektive, Mbikqyrësi i Punimeve do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e marra deri në ditën e lëshimit të certifikatës.

**Neni 41** *Zgjidhja e Mosmarrveshjeve*

41.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që do t'u lindë gjatë realizimit të kësaj kontratë.

41.2 Në rast se palët nuk bien dakort atëhere për sqarimin e mosmarrëveshjeve ngrihet një grup i përbërë nga tre ekspertë ku secila palë ka paraqitur një ekspert kurse i treti pranohet nga të dy palët. Në rast se problemi nuk zgjidhet nga grupi i ekspertëve atëhere palët do t'i drejtohen Gjykatës Korçë.

**Neni 42** *Legjislacioni Bazë*

42.1 Ligji i aplikueshëm do të jetë Legjislacioni Shqiptar.

**Neni 43** *Sigurimi i Kontratës*

43.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e duhur dhe konkretisht në shumën: 5 113 280.5 ( Pesë milion njëqindetrembëdhjetë mijë dyqindetëdhjetë pikë pesë ) Lekë me tvsh e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.

43.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



43.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

**Neni 44      *Informacioni Konfidencial***

44.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

**Neni 45      *Komunikimi***

45.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet më shkrim.

45.2 Çdo njoftim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

45.3 Çdo miratim i dhënë duhet të bëhet me shkrim.

45.4 Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim në adresat e deklaruara nga palët, në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.

**Neni 46: *Lajmërimet***

46.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

46.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 47. *Përfaqësimi i Palëve***

47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.


47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

**BASHKIA KOLONJË**



**ARKONSTUDIO Sh.p.k**



**Eral Construction Company Shpk**



*Neni 48. Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve*

48.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

*Neni 49. Dispozita të Fundit*

49.1 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të dy palët. Te gjitha referencat e diteve do të jene kalendarike. Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje, katër nga të cilat i mban Autoriteti Kontraktor dhe dy kopje i mban Kontraktori.

KONTRAKTORI

BASHKIMI I OPERATORËVE

**ARKONSTUDIO Sh.p.k**  
PËRFAQËSUESIT/ LIGJOR

Krenar DILA

*Krenar Dila*



AUTORITETI KONTRAKTOR  
BASHKIA KOLONJE  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

**ERAL CONSTRUCTION COMPANY Shpk**  
PËRFAQËSUESIT/ LIGJOR

Ervin QËNDRO

*Ervin Qëndro*




KRYETARI  
ARBEN MAJO



BASHKIA KOLONJË

ARKONSTUDIO Sh.p.k Eral Construction Company Shpk





Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 5 Tiranë, Shqipëri  
Tel: 00355 4 238999 / 238899 Fax: 00355 4 223841 Cel: 00355 66 20 70 659 E-mail: [info@eurosig.al](mailto:info@eurosig.al) [www.eurosig.al](http://www.eurosig.al)  
Nipt-i : K41926801W

Seria NR 0310797

## FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES

Ref. \_\_\_\_\_  
Data 11/07/2016  
Për: BASHKIA KOLONJE  
(Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor)

Në emër të: JV/ ARKONSTUDIO SHPK, ERAL KONSTRUKSION COM Nipt-i: 420190041, K82230002K  
(Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar) PANY, TIRANE

Procedura e prokurimit (nëse zbatohet): \_\_\_\_\_  
(Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor)

Përshkrimi i shkurtër i kontrates RIKONSTRUKSION I RRUGEVE DHE FASADAVE TE SHESHIT RILINDJA ERSEK  
(Lloji procedures dhe objekti)

Publikimi(nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike nr \_\_\_\_\_, date \_\_\_\_\_

Duke iu referuar procedurës së lartpërmëndur, dhe me kusht që JV/ ARKONSTUDIO SHPK, ERAL KONSTRUKSION  
(emri i ofertuesit të percaktuar fitues)

t'i jetë akorduar kontrata, ne vertetojmë se JV/ ARKONSTUDIO SHPK, ERAL KONSTRUKSION COMPANY ka derdhur  
(emri i ofertuesit të percaktuar fitues)

një depozitë pranë Shoqërisë Sigurimeve "EUROSIG" sh.a., në një shumë prej:

Lekë 5,113,281.00 ( PESE MILION E NJEQIND E TREMBEDHJETE MIJE E DYOQIND E TETE )  
(shuma me fjale) DIJHJETE E NNE LEKE

si kusht për garantimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me  
BASHKIA KOLONJE  
(Emri autoritetit kontraktor)

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e BASHKIA KOLONJE  
(Emri autoritetit kontraktor)

Vlerën e siguruar, brënda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmëndë mos-përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës

Lëshuar në TIRANE më 11/07/2016 20

SHOQERIA E SIGURIMEVE "EUROSIG" sh.a.

Përfaqësuesi \_\_\_\_\_

(Emri, mbiemri, firma, vula)

18797